



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

Nr. ____ Prot.

Datë 10.12.2008

V E N D I M

Nr.94, datë 10.12.2008

Për

“Marrjen e disa masave për mbrojtjen e konkurrencës në tregun e tranzitimit dhe interkoneksionit në komunikimet elektronike dhe mbylljen e hetimit ndaj operatorëve AMC Sh.A, Vodafone Albania ShA. dhe Albtelecom”.

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

Znj. Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
Z. Lush	PERPALI	Zv/Kryetar
Znj. Servete	GRUDA	Anëtare
Z. Koço	BROKA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10/12/2008, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i sjelljes së Operatorëve me Fuqi të Ndjeshme në Tregun e komunikimeve elektronike në lidhje me tranzitimin dhe interkoneksionin.

Baza ligjore: Neni 24, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Pas shqyrtimit të:

- Raportit të Hetimit Pararprak “Mbi abuzimin ose jo me pozitën dominuese të Albtelecom sh.a, Vodafone sh.a dhe Albanian Mobile Communication sh.a”,
- Relacionit të Grupit të Punës dhe
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

V Ë R E N S E:

1. Shoqata e Operatorëve Alternativë dhe disa nga operatorët alternativë kanë paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës

disa ankesa lidhur me sjelljen e operatorëve me fuqi të ndjeshme në treg duke pretenduar se kanë abuzuar me pozitën dominuese duke kufizuar konkurrencën e lirë dhe efektive në tregun e komunikimeve elektronike.

2. Me marrjen e këtyre ankesave Autoriteti i Konkurrencës ka filluar menjëherë monitorimin e këtij tregu si dhe ka zhvilluar seanca konsultative me palët e interesuara. Me vendimin Nr. 7, datë 07/05/2008 të Sekretarit të Përgjithshëm filloi procedura për hapjen e hetimit paraprak mbi abuzimin ose jo me pozitën dominuese të Albtelecom Sha. Vodafone Sha. dhe Albanian Mobile Communications Sha.
3. Gjatë kësaj kohe Autoriteti i Konkurrencës ka bashkëpunuar me AKEP (ERT) duke koordinuar e negociuar marrjen e masave të ndryshme për përmirësimin e situatës në treg.
4. Autoriteti i Konkurrencës, me anë të vendimit nr. 77 datë 11.04.2008 i ka rekomanduar AKEP (në atë kohë ERT) që të plotësojë kuadrin nënligjor për tranzitimin e thirrjeve ndërkombëtare si dhe për ofrimin e shërbimeve alternative si VOIP.

5. Tregu përkatës

Tregu i Produktit lidhet me dy nën-tregje:

Tranzitimi i thirrjeve ndërkombëtare përkufizohet si përcjellja e thirrjeve telefonike nga një operator midis pikave të interkoneksionit të këtij operatori me operatorë të tjerë të cilët nuk interkonektohen direkt midis tyre. Tranzitimi ndërkombëtar shërben për të kompletuar thirrjet telefonike dalëse dhe hyrëse ndërkombëtare. Kërkuesit e shërbimit të tranzitimit ndërkombëtar janë ofruesit e shërbimeve të thirrjeve ndërkombëtare përdoruesve fundor në Shqipëri.

Interkoneksioni është i nevojshëm për operatorët për të origjinuar, terminuar dhe tranzituar thirrjet dhe ky shërbim nuk mund të zëvendësohet me asnjë shërbim tjetër.

Tregu gjeografik është gjithë territori i Shqipërisë.

6. Ndërmarrjet nën hetim

- **Albtelecom** është themeluar në Shkurt 1992 dhe deri në 1 Tetor 2007 ka qenë në pronësi të shtetit shqiptar. Në 1 Tetor 2007 përfundoi procedura e privatizimit të 76% të aksioneve të Albtelecom nga kompania turke Calik Energjie, ndërkohë që 24 % e aksioneve të Albtelecom sh.a janë në pronësi të

shtetit shqiptar. Albtelecom sh.a. është operatori i vetëm kombëtar i rrjetit publik fiks me licencë të Klasës së I.

- **Albanian Mobile Communications** u licencua në Maj të vitit 1996. Kapitali i kësaj shoqërie ishte 100% shtetëror. Në vitin 2000 AMC u privatizua. 85% të aksioneve të kësaj shoqërie i zotëron konsorciumi Telenor-Cosmote, 12.6% të aksioneve i zotëron Ministria e Ekonomisë dhe 2.4% i zotërojnë aksionerët e vegjël, punonjës të AMC në kohën e privatizimit. AMC ofron shërbimet e veta në tregun e telefonisë së lëvizshme.
- **Vodafone Albania** u licencua në 9 Qershor 2001. Vodafone Albania është operatori i dytë i licencuar për telefoninë e lëvizshme dhe është pjesë e grupit më të madh të telefonisë në botë Vodafone. Vodafone ofron shërbimet e tij në tregun e telefonisë së lëvizshme.

7. Albtelecom ka nënshkruar me operatorin alternativ Hermes Communications amendamentin nr.1. Aneksi 8, Paragrafi I, germa C. SHËRBIMET E TRAFIKUT, tranzitimi i thirrjeve, germa c) të Marrëveshjes së Interkoneksionit, me anë të të cilit i njihet e drejta H-C të ofrojë tranzitimin e thirrjeve ndërkombëtare drejt rrjetit të Albtelecom, në ndryshim nga MI e tjera të nënshkruara me operatorët e tjerë alternativë. Nga hetimi paraprak ka rezultuar se kjo marrëveshje “de jure” është në fuqi, ndërkohë që “de facto” nuk është zbatuar asnjëherë, pasi është konsideruar nga Albtelecom një lapsus në zbardhjen e kontratës. Ky fakt konfirmohet edhe nga H-C ¹ e AKEP².
8. Albtelecom u ka faturuar disa operatorëve alternativë shërbimin e lidhjes së portave E1 (kapacitetet 2 Mbps) me 30 mijë lekë +2 mijë lekë për çdo kilometër shtesë nga pika e interkoneksionit. Ky faturim është i pabazuar në Marrëveshjen e Interkoneksionit të lidhura mes Albtelecom dhe operatorëve alternativë. Albtelecom me anë të shkresës nr. 2763/2 të datës 22.04.2008, drejtuar AKEP,³ shprehet se ka tërhequr faturimin e këtij shërbimi ndaj operatorëve ruralë që prej janarit 2008. Gjithashtu, kjo ndërmarrje ka deklaruar se do të kthejë shumat e paguara nga ato operatorë alternativë të cilët kanë pranuar faturat⁴.
9. Një pjesë e operatorëve alternativë pretendojnë se janë detyruar të nënshkruajnë një deklaratë me kusht rilidhjen e

¹ Shkrese Nr. Prot. 108. Datë 11.06.2008 e Hermes Communications, fq. 3

² Shkresa nr 1485/3 Datë 19.6.2008 e ERT,Fq.2-4

³ Ib. id. Fq. 2.

⁴ Shih psh. Shkresën në. 914. datë 12.11.2008 të Albtelekom drejtuar Nisatel ku theksohet se “Albtelekom ... nuk ka vijuar faturimin e qarqeve 2 Mbps dhe asnjë lloj pagese tjetër që nuk është parashikuar në MI., po realizon anulimin e faturimeve të bëra për këto qarqe dhe po procedon për rimbursimin e atyre pagesave ..”.

interkoneksionit me Albtelecom. Një nga kushtet e deklaratës është të depozitojnë një garanci bankare (që variojnë nga 300 në 1000 euro) në llogarinë e Albtelecom e cila do të merret nga kjo ndërmarrje në rast mosrespektimi të kushteve të sipërcituara. Nga hetimet rezulton se është e pamundur të provohet se nënshkrimi i kësaj deklarate është detyruar nga Albtelecom apo kanë qenë vetë operatorët alternativë që e kanë propozuar këtë deklaratë.

10. Nga hetimi paraprak rezultoi se OA-të nuk tranzitojnë thirrje në rrjetet e AMC dhe Vodafone pra “de facto” nuk ka një treg terminimi në rrjetet e operatorëve të telefonisë së lëvizshme.
11. Lidhur me tarifat e terminimit që aplikojnë Albtelecom, AMC dhe Vodafone ndaj operatorëve alternativë nga hetimi rezulton se nuk ka fiksime çmimesh apo diskriminime midis operatorëve të ndryshëm ruralë. Të tre OFNT-të aplikojnë tarifa të ndryshme edhe për interkoneksionin me operatorët alternativë.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja d, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

I. Marrjen e masave për mbrojtjen e konkurrencës në tregun e tranzitimit dhe interkoneksionit në komunikimet elektronike, si më poshtë:

I.1 Moskryerjen e asnjë veprimi të njëanshëm apo pa paralajmërim, jashtë kushteve të marrëveshjeve të interkonjeksionit dhe në kundërshtim me Ligjin Nr. 9121, datë 28.7.2003 “PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS”, nga operatorët e ndryshëm në tregun e komunikimeve elektronike.

I.2 Të kërkojë nga Albtelecom sh.a, dhe Hermes Communications shfuqizimin formal të nëntitullit “tranzitimi i thirrjeve”, gërma c) të Amendamentit nr. 1. Aneksi 8, Paragrafi I, gërma C. SHËRBIMET E TRAFIKUT, të Marrëveshjes së Interkoneksionit H-Communications brenda një periudhe 1 mujore.

I.3 Albtelecom sha. dhe Operatorët Alternativë, të cilat kanë depozituar shuma të ndryshme në llogarinë e Albtelecom në formë garancie bankare pa kushte, apo pagesa të tjera të paparashikuara në marrëveshje të dyanshme të kthejnë çdo

pagesë të bërë jashtë këtyre detyrimeve, brenda një periudhe 3 mujore.

I.4. Albtelecom SHA, të njoftojë Komisionin e Konkurrencës për marrjen e masave të mësipërme brenda 15 ditëve nga afati i fundit i përcaktuar në pikat I.2 dhe I.3.

II. Mbylljen e hetimit në tregun e telekomunikacioneve ndaj Albtelecom, AMC sh.a dhe Vodafone Albania sh.a për sjelljen e tyre në tregun e tranzitimit të telefonatave ndërkombëtare dhe interkoneksionit.

III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi, njoftimin e palëve të interesuara dhe monitorimin e vazhdueshëm të këtyre tregjeve për çdo sjellje që mund cenojë konkurrencën e lirë dhe efektive.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush PERPALI

Servete GRUDA

Koço BROKA

(_____)
Zv/Kryetar

(_____)
Anëtare

(_____)
Anëtar

Lindita MILO (LATI)

KRYETARE